



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 76, datë 24.07.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. MIMOZA QINAMI NË VENDIN  
VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA  
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Ardian Dvorani</b>	- Kryetar
<b>Vitore Tusha</b>	- Zëvendëskryetare
<b>Arta Marku</b>	- Anëtare
<b>Margarita Buhali</b>	- Anëtare
<b>Fatjona Memçaj</b>	- Anëtare
<b>Fatri Islamaj</b>	- Anëtar/Relator
<b>Eriol Roshi</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 24.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTAR**

**NË GJYKATËN KUSHTETUESE:** **Znj. Mimoza QINAMI**

**OBJEKTI:**

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të **znj. Mimoza Qinami**, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarit të Këshillit, **z. Fatri Islamaj**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarës Altina Xhoxhaj.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Mimoza Qinami.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, z. Fatri Islamaj.

7. Znj. Mimoza Qinami, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Mimoza Qinami, gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 08.04.2019, kandidatja Mimoza Qinami është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

9. Në datën 12.04.2019, kandidatja Mimoza Qinami ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Mimoza Qinami, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Mimoza Qinami e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115.2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.1/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Mimoza Qinami dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Mimoza Qinami dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidates Mimoza Qinami, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- c) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Mimoza Qinami.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit

236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Mimoza Qinami sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1123/66 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Mimoza Qinami.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Mimoza Qinami, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr.120 prot., datë 17.04.2019), Shërbimit Informativ të Shtetit (shkresa nr.114 prot., datë 17.04.2019), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (shkresa nr.118 prot., datë 17.04.2019) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr.117 prot., datë 17.04.2019).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar në pikën 19 për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr.1554 prot., datë 10.06.2019 dhe nr.730/1 prot., datë 20.05.2019.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 112 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Mimoza Qinami për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.272 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Mimoza Qinami.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të



Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Mimoza Qinami në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Mimoza Qinami.

26. Në datat 19.04.2019 dhe 12.07.2019, Këshilli i ka kërkuar në rrugë elektronike kandidates Mimoza Qinami të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë sipas vlerësimit të saj në lidhje me kushtin ligjor të vjetërsisë në punë, për të shpjeguar dhe depozituar kopje të librezës së punës, vërtetime nga sigurimet shoqërore si edhe nga organet tatimore për të verifikuar nëse është ushtruar prej saj profesioni i avokatit, përfshirë kopje e licensës së ushtrimit të këtij profesioni nga organet tatimore. Ndërsa në lidhje me kushtin ligjor që nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit (përfshihen 3 vitet e fundit), kjo në zbatim të neni 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 199 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 115/2016, i është kërkuar të paraqesë vërtetimin përkatës nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjithashtu, meqenëse nga shkresa nr. 94/1 prot, datë 10.05.2019 e lëshuar nga Agjencia e Trajtimit të Konkensioneve ku aktualisht është e punësuar kandidatja, parashtrohet se ndaj saj është dhënë masa disiplinore “vërejtje” në datën 20 Qershor 2018, i është kërkuar shpjegim nëse i është komunikuar kjo masë disiplinore, nëse ka ndërmarrë ndonjë veprim për kundërshtimin e saj në rrugë administrative apo gjyqësore dhe cilat janë rezultatet e atij procesi. Po kështu i është kërkuar nëse pozicionet e punës së deklaruar mund të barazohen me ato të specifikuar në kuptim të nenit 7/a i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", me çfarë ligji rregullohet marrëdhënia e punës, si edhe nëse është parashkruar masa disiplinore.

27. Në datën 25.04.2019, kandidatja Mimoza Qinami ka paraqitur me shkrim në rrugë elektronike shpjegime dhe dokumente shtesë, përfshirë jetëshkrim me të dhëna të aktualizuara sipas formatit të treguar nga KED.

28. Ndërsa në datën 15.07.2019, kandidatja Mimoza Qinami ka paraqitur me shkrim në rrugë elektronike shpjegime dhe dokumente shtesë në lidhje me vjetërsinë në punë, mbi statusin e marrëdhënies së punës dhe ligjin e posaçëm i cili rregullon këtë marrëdhënie, si dhe në lidhje me masën disiplinore.

29 Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidatja Mimoza Qinami ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidates si Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr.276 prot., datë 19.04.2019*), Dhoma

Kombëtare e Avokatisë (*shkresa nr.323 prot., datë 07.05.2019*), Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (*shkresa nr.322 prot., datë 06.05.2019 dhe me nr.428 prot., datë 12.07.2019*).

30. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Institutit i Sigurimeve Shoqërore (*shkresa nr.3079/1 prot., datë 24.04.2019*), Dhoma e Avokatisë (*shkresa nr.211 prot., datë 07.05.2019*) dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (*shkresa nr.94/1 prot., datë 10.05.2019 dhe nr.138/1 prot., datë 15.07.2019*).

31. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nga shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në mbështetje të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016 si edhe të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje në lidhje me vjetërsinë në punë të paktën 15 vjet, si dhe në lidhje me masën disiplinore që është në fuqi, të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 24.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj.Mimoza Qinami, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

33. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Mimoza Qinami.

34. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

35. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 24.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

36. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

37. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtëzara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Mimoza Qinami.

38. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, ndër të tjera, parashtrori se:

- nuk ka dokumentacion të plotë që vërteton plotësimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore të parashikuara nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 dhe nenet 199,200 dhe 201 të ligjit nr. 115/2016,

- nga verifikimit në ATRAKO rezulton se kandidatja ka masë disiplinore në fuqi, e pa ankimuar, me afat shuarje 2 vjet nga data e njoftimit. Sipas kandidates institucioni nuk duhet të jetë pjesë e shërbimit civil deh deklarimi i statusit të nëpunësit civil është bërë njëanshmërisht nga ana e DAP. Rekomandohet ti kërkohet DAP nëse qëndron ky pretendim dhe nëse kandidatja është nëpunëse civile. Nga kjo varet edhe afati i parashkrimit të masës disiplinore të dhënë ndaj kandidates.

## II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

39. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidates, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidates Mimoza Qinami për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

40. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”*

41. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

*a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*

*b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*

*c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*

*ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*

*d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

*dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*



2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

42. Kushtet e kandidimit për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 40 dhe 41 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu zgjedhur Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti i Republikës në rastin konkret, i cili është organi i emërtesës për këtë pozicion vakant.

43. Nëse kandidati për Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

44. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidaten Mimoza Qinami, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga pika 4 i nenit 125 të Kushtetutës, pika 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike..., si dhe të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

45. Për sa i përket procedurës së verifikimit të vjetërsisë në punë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pas një analize të hollësishme, ka ardhur në përfundimin se kandidatja Mimoza Qinami, nuk i plotëson këto kriter.

46. Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mbi gjetjet e sipërcituara, është njoftuar kandidatja Mimoza Qinami në datë 12.07.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

47. Kandidatja Mimoza Qinami, në datë 15.07.2019, në rrugë elektronike, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe pretendon se :

- *Pozicionet e punës së deklaruar mundet të barazohen me ato në kuptim të nenit 7/a të Ligjit nr.8577/2000, duke pasur një eksperience pune shumë vjeçare, si juriste e nivelit të lartë në administratën publike.*
- *Cilësimi i punës profesionale administrative ka qenë i tille në mbrojtje të interesit publik si eksperte ligjore në dhënien e konsulencave pranë Institucioneve të*

- ndryshme Qendrore dhe Lokale në projekte të rëndësishme dhe në vlera të konsiderueshme monetare me përbërje komisioni në rang Drejtorë Drejtorie të Ministrive të ndryshme dhe në dobi të interesit të lartë publik, social dhe ekonomik.
- Operimi në projekte të ndryshme me organizata të huaja dhe OJF, si eksperte ligjore dhe trajnuese mbi të drejtat e njeriut, me target grupe vunerabel si gra të divorcuara, dhunuara, apo fëmijë të braktisur, si dhe fëmijë të minoriteteve të ndryshme, duke dhënë kontributin tim në njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuar në të drejtën kushtetuese.
  - Kontributi disa vjecar në Institucione të ndryshme publike në përgatitjen e akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse duke kontribuar si një katalizator për një shtet ligjor sa me afektues dhe realizues, si dhe ndjekjen e proceseve të ndryshme ligjore ; civile dhe administrative në shkallet e ndryshme të Gjyqësorit në mbrojtje të Institucionit operues, me ka ndihmuar dhe në njohjen e problematikave deri në realizimin e një të drejte ligjore.
  - Agjensia e Trajtimit të Konkencioneve (ATRAKO, në zbatim të VKM –së nr.853 date 30.09.2013 është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.Struktura organizative dhe detyrat funksionale të ATRAKO-s rregullohen nga një bazë ligjore e posacme për këtë Institucion juridik publik si :  
Urdhëri i Kryeministrit nr.123 date 16.10.2012 " Miratimi i struktures dhe organikës së Agjensisë .  
Rregullore e Agjensisë së Trajtimit të Konkencioneve Nr.98 date 22.06.2009.  
VKM nr.150 date 22.03.2007 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjensisë së Konkencioneve "i ndryshuar.  
Ligji 9663 datë 18.12.2006 "Për Konkensionet" i ndryshuar dhe Ligji nr.125/2013 datë 25/04/2013 "Për Konkensionet/ PPP" , në funksion të operimit të kësaj Agjensie.
  - Konform kësaj baze ligjore ka funksionuar dhe janë lidhur marrëdhëniet juridike, duke njohur të drejtat dhe detyrimet midis palëve punëdhënës-punëmarrës me kontrata individuale të punës. Sipas këtyre dispozitave ligjore efekti i dhënies së masës është marrë jashtë procedurave ligjore mbi të cilat Agjensia e Konkencioneve ATRAKO normon juridikisht punën e saj dhe kjo mase I bie të jetë parashikuar brenda 6 muajve . Por kontradiksioni i zbatimit të normave ligjore qëndron në konfondimin e akteve nënligjore pikërisht :VKM nr. 150 date 22.03.2007 i Agjensisë së Konkencioneve( ATRAKO) me VKM nr.116 date 05.03.2014 "Për Statusin e Nëpunësve aktuale që përfitojnë statusin e nëpunësit Civil", ku nëpërmjet një akti të deklarimit të statusit të punësimit të vendosur në mënyrë të njëanshme nga DAP, edhe punonjësit e Agjensisë i kanë bërë pjesë penalizimi në këtë status me këtë akt nënligjor dhe udhëzimit të tij.
  - Megjithatë në kohën kur më është dhënë masa"Vërejtje", e kam kundërshtuar atë në rrugë administrative, me shkresat përkatëse deri në hierarkinë më të lartë administrative. Arësyet pse une ndoqa këtë rrugë ankimimi :  
a) Eprori përkatës nuk më pajisi sipas ligjit në marrjen e plotë të provave si psh procesverbali i mbledhjes, ku një kopje nuk mu dha nga eprorët duke u justifikuar se do të jepej në seancë gjyqësore nëse do shkoja, (kjo gjë është dhe një konflikt i hapur apo sjellje intimiduese e cila vlen të analizohet në të drejtat e kushtëzuar që janë vendosur në statusin e nëpunësit civil) për ankimim në gjykatë në kohë konflikti të hapur punëdhënës-punëmarrës.

*Kjo gjë nuk u bë rastësisht nga eprorët, por u bë qëllimisht pasi objekti i përshtatur për rrethanat e pretenduara për masën që ishte në fillim, ndryshoi gjatë procedurës deri në dhënien e masës “Vërejtje”.*

*b-Gjykatat duke qënë në kushtet e reformimit të sistemit të Drejtësisë kanë pasur vonesa të procedurave ligjore të rasteve të ndryshme. Nisur nga ky realitet objektiv, duke e krahasuar me afatin e parashkrimit të masës, mendova se ankimi administrativ ishte ankimi me i afërt procedural për zgjidhje në kohe të situatës.*

*Për sa më sipër, duke menduar dhe gjykuar gjendjen reale të kësaj “mase të lehtë”, ajo është dhënë jo në garancinë ligjore, faktet e përdorura joreale, aspak e drejtë, tendencioze, në keqpërdorim dhe abuzim të pushtetit nga ana e eprorëve, por dhe referuar bazës ligjore mendoj se kësaj mase disiplinore i është parashkruar afati ligjor për penalizim.*

48. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbi bazën e verifikimeve të kryera, i rezulton se lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Mimoza Qinami ka ushtruar veprimtari profesionale si :

- a) Përgjegjese e Burimeve Njerëzore, për periudhën “1993-1994”, pranë Ndërmarrja “Albturist-Dajti”- Tiranë.
- b) Juriste /Anëtare e Këshillit Drejtues, për periudhën “1994 – 1998”, pranë Ndërmarrja “Albturist-Dajti” –Tiranë.
- c) Juriste e kredise /Kryetare e Bordit të Prokurimeve /Anetare e Komitetit të Kreditit, për periudhën “1998 – 2003”, pranë Banka e Përgjithshme e Kursimeve – Tiranë;
- ç) Avokate / Eksperte ligjore, për periudhën “2003 – 2006”, pranë Shoqata ( MDG), “Mbrotjtja e të Drejtave të Grave Qytetare dhe Fshatare”- Berat;
- d) Zv.Drejtores e Përgjithshme e Shoqërisë “Sicred” sh.a dhe Anëtare e Bordit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës “Credins”, për periudhën “2006 – 2007”, pranë Shoqëria e Sigurimit të Jetës “Sicred”sh.a.
- dh) Zv.Kryetare dhe Drejtores e Përgjithshme e Departamentit Juridik dhe Kredisë, për periudhën “2007 – 2008”, pranë Ministria e Finances – Agjensia e Trajtimit të Kredive (ATK ).
- e) Eksperte ligjore / Juriste, për periudhën “2010 – 2019”, pranë Ministria e Financave dhe Ekonomisë–Agjensia e Trajtimit të Koncensioneve.

49. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër në pikat 47 dhe 48, Këshilli konstaton se kandidatja Mimoza Qinami nuk ka ushtruar së paku 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

50. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Mimoza Qinami rezulton të ketë masa

disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidatja Mimoza Qinami gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

51. Sipas shkresë nr.94/1 prot., datë 10.05.2019 të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, na bëhet me dije se kandidatja Mimoza Qinami, në pozicionin e specilaistet, në bazë të vendimit të Eprorit Direkt nr.2 datë 20.06.2018, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

52. Gjithashtu, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve me shkresën nr.138/1 prot., datë 15.07.2019, na bëhet me dije se kandidatja Mimoza Qinami është njohur me masën disiplinore “Vërejtje”, marrë me vendimin e Eprorit Direkt nr.2 datë 20.06.2018, si dhe referuar nenit 61 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.152/2013 “Për shërbimin civil” kjo masë nuk është shuar, pasi afati është 2 vite nga data e njoftimit.

53. Në shpjegimet e saj, kandidatja ka ngritur probleme ligjore të natyres së marrëdhënies së punës që ajo ka me punëdhënësin, afatit të parashkrimit të masës dhe ka pranuar se nuk ka ankimuar atë në rrugë gjyqore, por vetëm në rrugë administrative tek Ministri i Financave, si dhe që nuk rezulton të jetë shfuqizuar kjo masë në rrugë administrative. Ndërkohë nga komunikimi me Agjencinë e trajtimit të koncesioneve, punëdhënësi i kandidates pranë KED është përcjellë shkresa nr.138/1 prot dt.15.07.2019 sipas të cilës është sqaruar se masa vërejtje i është komunikuar rregullisht kandidates, nuk është ankimuar prej saj në gjykatë dhe është në fuqi sipas nenit 61 të ligjit nr.152/2013 për një periudhë dy vjet nga momenti i njoftimit.

54. Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ndryshe nga sa pretendon kandidatja Mimoza Qinami, vlerëson se masa disiplinore vërejtje ndaj saj ka qënë në fuqi në momentin e kandidimit sipas nenit 199/d të ligjit nr.115/2016, për arsyet se masa disiplinore ndaj saj është dhënë në datën 20.06.2018. Kandidatja ka kandiduar për vendin vakand të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në datën 21.03.2019. Pra nga momenti i dhënies së masës deri në momentin e kandidimit kishte kaluar afati 9 muaj nga dhënia e saj. Sipas vendimit nr.2, datë 20.06.2018 për dhënie e masës disiplinore rezulton se ajo është dhënë në bazë të nenit 57/4 e 58 të ligjit nr.152/2013 i ndryshuar, duke u vlerësuar se kandidatja ka statusin e nëpunësit civil. Për punonjësit publikë të kësaj kategorie parashkrimi i fuqisë së masës disiplinore bëhet në përputhje me ligjin nr.152/2013. Sipas nenit 61 të këtij ligji, “*Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve: a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën "a" të nenit 58 të këtij ligji; .....*”. Shkronja “a” e nenit 58 përcakton masën disiplinore “vërejtje”. Për rrjedhojë, në rrethanën kur nuk ka kaluar afati 2 vjet nga njoftimi i kësaj mase disiplinore kandidates Mimoza Qinami, atëherë kjo masë ka qënë në fuqi në kohën e kandidimit në muajin Mars 2019. Ky fakt konfirmohet edhe nga shkresa e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dt.15.07.2019.

55. Edhe në referim të kuadrit ligjor e nënligjor të treguar nga kandidatja Mimoza Qinami rezulton se VKM nr.150/2007 i ndryshuar parashikon se: “10. *Marrëdhëniet e punës për unonjësit e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) rregullohen me "Kodin e Punës" dhe aktet e tjera, të nxjerra në zbatim të tij.*”. Nga ana tjetër, vendimi i Këshillit të ministrave nr.116 dt.05.03.2014 ka përcaktuar se “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione në shërbimin civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549/1999. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, apo njësia përgjegjëse, për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, verifikon procedurën e



rekrutimit dhe lëshon për çdo nëpunës aktin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

56. Në nenin 67 të ligjit nr.152/2013 parashikohet se punonjësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549/1999 apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë. Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit.

57. Në përputhje me këto përcaktime ligjore del se statusi i punësimit të punonjësve përcaktohet nga DAP, duke pasur në konsideratë mënyrën e rekrutimit të punonjësve dhe përcaktimet e nenit 67 të ligjit nr.152/2013. Në kushtet kur organi kompetent ka verifikuar dhe ka përcaktuar statusin e pozicionit të punës së kandidatës Mimoza Qinami sipas ligjit nr.152/2013 atëherë marrëdhënia e punësimit të saj rregullohet nga ky ligj dhe jo nga VKM nr.150/2007. Për më tepër kjo VKM nuk mund të thuhet se shkakton përplasje me VKM nr.116/2014, duke qenë një akt që rregullon në mënyrë të përgjithëshme marrëdhëniet e punësimit të cdo kategorie punë në Agjenci, ndërsa VKM nr.116/2014 bën një rregullim specifik të marrëdhënies së punës. Në rastin konkret për kandidaten Mimoza Qinami, sikurse ajo e pranon në shpjegimet e saj, është deklaruar statusi i nëpunësit civil nga DAP sipas VKM nr.116/2014. Si rrjedhim gjithë procedura e marrjes dhe e shuarjes së masave disiplinore ndaj saj rregullohet me ligjin nr.152/2013.

58. Edhe në rast se do të pranohej pretendimi i kandidatës Mimoza Qinami se marrëdhënia e saj e punësimit rregullohet nga Kodi i Punës, atëherë përsëri rezulton se masa disiplinore e dhënë ndaj saj nuk është shuar në momentin e kandidimit. Sipas nenit 203 të Kodit të Punës *"Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit."* Kjo dispozitë nuk bën asnjë diferencim për parashkrimin e masave disiplinore në varësi të natyrës së saj. Ndërkohë që, nga dhënia e masës deri në momentin e kandidimit kanë kaluar vetëm 9 muaj. Nga ana tjetër nga kandidatja nuk është paraqitur asnjë kontratë individuale ose kolektive që të parashikojë afate më të shkurtra parashkrimi të masave disiplinore.

59. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbente motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

60. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidaten Mimoza Qinami është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nga shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

61. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatës Mimoza Qinami në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

### **VENDOSI:**

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatës Mimoza Qinami, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Mimoza Qinami.
3. Kandidatja Mimoza Qinami ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**ARDIAN DYORANI**

